



# **Ekstremizmi i dhunshëm i krahut të djathtë në Ballkanin Perëndimor:**

## **Një përmbledhje e sfidave specifike sipas vendeve për P/KEDH.**

Autor **Mirza Buljubašić**,  
Anëtarë i grupit të ekspertëve të RNR në Ballkanin Perëndimor

Radicalisation Awareness Network

**RAN**   
Practitioners



**Ekstremizmi i dhunshëm i krahut të djathtë në Ballkanin Perëndimor:**

**Një përmbledhje e sfidave specifike sipas vendeve për P/KEDH.**

## PARALAJMËRIM JURIDIK

Ky dokument është përgatitur për Komisionin Evropian por i njëjti reflekton pikëpamjet vetëm të autorit, dhe Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për çfardo pasoje të mundshme që mund të gjenerohet nga ripërdorimi i këtij botimi. **Për më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian mund të gjeni në faqen e internetit (<http://www.europa.eu>)**

Luksemburgu: Zyra e botimeve e Bashkimit Evropian, 2022

© European Union, 2022



Politika e ripërdorimit e dokumenteve të Bashkimit Evropian zbatohet sipas Vendimit të Komisionit 2011/833/EU me datë 12 dhjetpr 2011 për ripërdorimin e dokumenteve të Komisionit (OJ L 330, 14.12.2011. f. 39). Nëse nuk prashihet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti është autorizuar sipas licesës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC-BY 4.0) <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>. Kjo nënkupton se përdorimi ose ripërdorimi lejohet me kusht që t'i jepet njohja e duhur dhe të tregohen ndryshmet e mundshme.

Lidhur me përdorimin ose riprodhimin e elementeve të cilat nuk janë në pronësi të Bashkimit Evropian, do të duhet të kërkohet leje drejtpërdrejtë nga pronari përkatës.

## Hyrje dhe kontekst

Vitet e fundit shënuan një rritje të shqetësimit lidhur me potencialin për ekstremizëm të dhëshëm të krahut të djathtë (EDHKD) në Ballkanin Perëndimor: Shqipëri, Bosnjaë dhe Hercegovinë (BiH), Kosovë\*<sup>1</sup>, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi. Historikisht rajoni është konceptuar si vend politikisht jostabilë me një histori dhune e cila buron nga ideologjitë dhe veprimet (politike) të krahut të djathtë.<sup>2</sup> Ekspertët si dhe zyrtarët nga Ballkani Perëndimor ngrenë disa shqetësime lidhur me përhapjen e ekstremizimit të krahut të djathtë (EKD) në kontekstin e konfliktit politik. Andaj, ky punim përqendrohet si në lëvizjet dhe aktivitete jo akoma të dhunshme po ashtu edhe në ato tashmë të dhunshme në Ballkanin Perëndimor.<sup>3</sup>

Janë përdorur terma të ndryshme nga ekspertët dhe profesionistët në tentativë për të përshkruar ekstremizmin e dhunshëm të krahut të djathtë (EDHKD). Megjithatë nuk është arritur ndonjë përkufizim univerzal ose i përgjithshëm. Në vitin 2021 një grup i Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (BE) që merrte pjesë në Bashkëpunimi në bazë të projekteve<sup>4</sup> mbi ekstremizimin e dhunshëm të krahut të djathtë (Bullgaria, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Suedia) vendosën të adoptojnë definicionin vijues i cili nuk ka fuqi detyruese ligjore:

*“Ekstremizmi i dhunshëm i krahut të djathtë përbëhet nga akte të individëve ose grupeve që përdorin, nxisin, kërcënojnë, legjitimojnë ose mbështesin dhunën dhe urrejtjen për të çuar përpara qëllimet e tyre politike ose ideologjike, të motivuara nga ideologji të bazuara në refuzimin e rendit demokratik dhe vlerave dhe të drejtave themelore, dhe të përqendruara në nacionalizmin përjashtues, racizmin, ksenofobinë dhe/ose intolerancën e lidhur me to.”*

Në këtë punim, EKD (Ekstremizmi i krahut të djathtë) si një ideologji e cila "ngërthen në vetvete autoritarizmin, antidemokracinë dhe nacionalizmin përjashtues dhe/ose holistik".<sup>5</sup> Disa karakteristika dalluese të këtij koncepti janë ksenofobia, racizmi dhe populizmi.<sup>6</sup> Manifestimi i tij i dhunshëm (EDHKD) është një formë e dhunës politike e cila nuk ka kufi të definuar qartë mes krimit të urrejtjes, terrorizmit<sup>7</sup> dhe veprimeve armiqsore (psh. gjenocid, krime kundër njerëzimit, krime lufte, spatsim etnik).<sup>8</sup> Një karakteristikë e EDHKD-së në Ballkanin Perëndimor është nacionalizmi etnik. Ky koncept mbështet mbi identitetin e një grupi të madhe i cili ka disa gjëra të përbashkëta - si miti i prejardhjes së përbashkët, gjuha dhe religjioni i përbashkët - dhe zanafilla e tij është në nativizëm (mbrojtjen e intereksave të popullit vendas), racizëm dhe shovinizëm, tradicionalizëm, ksenofobi, homfobi dhe supremacizëm.<sup>9</sup>

Ballkani Perëndimor ka një mori të faktorëve të riskut të cilët mund t'i atribuohen EKD-së, të tilla si çështjet ende të pa zgjidhura të identitetit, çështjet kundërshtuese ose konfliktoze historike dhe qeverisëse, në disa raste tranzicioni i vështirë në një demokraci plotësisht të arritur, konfliktet e ngrira si dhe mosfunksionimi administrativ. Po pra, njohuritë lidhur me EKD-në në Ballkanin Perëndimor kanë qenë të shpërndara dhe të

<sup>1</sup> Ky kategorizim është pa paragjykim për pozitën lidhur me statusin, dhe është në përputhje me UNSC 1244/1999 dhe Mendimin e GjND-së (Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë)

<sup>2</sup> Azinović, *Understanding violent extremism in the Western Balkans*, 3; Bećirević, Halilović and Azinović, *Radicalisation and violent extremism in the Western Balkans*, 6.

<sup>3</sup> Azinović, *Understanding violent extremism in the Western Balkans*, 3 and 14; Schmid, *Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin?*, 14.

<sup>4</sup> Bashkëpunimet e bazuara në projekte janë projekte të udhëhequra nga vendet e BE-së, me mbështetjen e Komisionit Evropian, për të nxitur shkëmbimin dhe bashkëpunimin në temat prioritare për parandalimin e radikalizimit. Informacione të mëtejshme mund të gjenden këtu: [https://ec.europa.eu/home-affairs/policies/internal-security/counter-terrorism-and-radicalisation/prevention-radicalisation/project-based-collaborations\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/policies/internal-security/counter-terrorism-and-radicalisation/prevention-radicalisation/project-based-collaborations_en).

<sup>5</sup> Carter, *Right-wing extremism/radicalism: reconstructing the concept*, 157.

<sup>6</sup> Carter, *Right-wing extremism/radicalism: reconstructing the concept*, 18.

<sup>7</sup> Counter-Terrorism Committee Executive Directorate, *Member States Concerned by the Growing and Increasingly Transnational Threat of Extreme Right-Wing Terrorism*, 2.

<sup>8</sup> Buljubašić & Holá, *Historical Trauma and Radicalisation: How Can Intergenerational Transmission of Collective Traumas Contribute to (Group) Radicalisation?* 3.

<sup>9</sup> Halilović & Veljan, *Exploring ethno-nationalist extremism in Bosnia and Herzegovina*, 11; Volkan, *Large-group identity, international relations and psychoanalysis*, 206-213; but see Malešević & Trošt-Pavasović, *Nation-States and Nationalism*.

paorganizuara. Ky dokument synon integrimin dhe sintetizimin e njohurive lidhur me EKD-në në Ballkanin Perëndimor; ky punim inkuadron sfidat më të rëndësoshme të parandalimit dhe kundërveprimit ndaj kësaj forme të ekstremizimit.

Pas një parathënie të shkurtër, do të zberthet ekstremizimi i krahut të djathtë (EKD) si dhe tendencat ndaj EDHKD-së në Ballkanin Perëndimor. Në mënyrë sistematike paraqiten aktorët dhe faktorët më të rëndësishëm të EKD-së - nga Shqipëria, BiH, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia - të cilët kontribuojnë në mbështetjen e EDHKD-së. Punimi përfundon me kontekstualizimin e radikalizimit të ekstremizimit të krahut të djathtë (EKD), me përshkrimin e sfidave kryesore për P/KEDh në Ballkanin Perëndimor dhe me disa rekomandime për politika/veprime.

## Sfidat specifike të vendeve të ndryshme lidhur me EKR-në në Ballkanin Perëndimor

### a. Shqipëria

Shqipëria është anëtare e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) si dhe kandidatë për anëtarësim në BE, pro e kaluara ende luan një rol të rëndësishëm në të tashmen e saj.<sup>10</sup> Vende ende vallafaqohet me shumë sfida sa i përket zhvillimit ekonomik dhe sociale, sundimit të së drejtës dhe korrupsionit.<sup>11</sup> Së fundmi, Shqipëria ka treguar përkishtim ndaj reformave për anëtarësim në BE si dhe livroi rezultate konkrete dhe të qëndrueshme.<sup>12</sup> Në disa momente vështirësia për t'u pajtuar me abuzimet e ish-regjimit totalitar në Shqipëri ndikon dukshëm shoqërinë bashkëkohore si dhe diskursin politik. Vetëm për të kritikuar dhe të treguar pakënaqësinë e tyre, njerëzit rrezikojnë të bëhen të prirë të mbështesin narrativin e EKD-së. Ashtu siç e tha edhe Gjergj Vurmo, Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në Tiranë, në një intervistë të tijë për Balkan Investigative Reportin Network:

"Kjo aludon se ka një potencial të madh për narrative populiste dhe narrative kundër "establishmentit", duke përfshirë ideologjitë dhe grupet shumë djathtë." <sup>13</sup>

Ekstremizmi i krahut të djathtë shqiptar është i pranishëm në diskursin politik. Disa parti politike të EKR-së promovojnë irredentizmin ose autonominë e territoreve fqinje të populluara nga shqiptarë dhe po ashtu kanë lidhje me partitë ekstreme djathtë në BE<sup>14</sup> Këto parti politike nuk janë zakonshme dhe luajnë një rol marginal në vendimmarrje.<sup>15</sup> Shpeshherë përdornin një retorikë të spikatur me ksenofobi dhe racizëm.<sup>16</sup> Lëvizja e parë haptazi neofashiste është *Pozita e Tretë Shqiptare*, e cila i kundërvihet komunizmit, demokracisë dhe religjioneve abrahamike dhe promovojnë tradicionalizmin, paganizmin dhe racizmin shqiptar. I ka synuar myslimanët shqiptarë nën petkun e diskursit të frikës nga globalizmi, e cila, së paku sipas tyre, është promovuar nga Xhorxh Soros dhe e majta. Numri i anëtarëve të kësaj lëvizje të EDHKD-së është i vogël dhe anëtarët janë anonim. Aktivitete e tyre online botohen në gjuhë angleze dhe shqipe. Me qëllim që të joshin rininë, zakonisht përdorin postime qesharake dhe joshëse dhe po ashtu përdorin edhe stilin DIY (bëjeni vetë) dhe fashwave.<sup>17</sup> Ka mungesë njohurishë lidhur me aktivitete rrjedhëse të

<sup>10</sup> Gjeta, *Albania Remains Hostage to its Communist Past*.

<sup>11</sup> Qirjazi & Shehu, *Community Perspectives on Preventing Violent Extremism in Albania*, 3.

<sup>12</sup> Më shumë informacion mbi Shqipërinë, përfshirë edhe angazhimin e vendit kundër ekstremizmit të dhunshëm, mund të gjendet në raportin vijues për vendin në fjalë të Komisionit Evropian: *Raporti mbi Shqipërinë 2021 2021 Komunikatë për Politikën e Zgjerimit të Bashkimit Evropian Versionin në gjuhë angleze e gjeni këtu: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en).*

<sup>13</sup> Kulogllija et al., *Balkan States Failing to Address Threat from Far-Right Extremism*.

<sup>14</sup> Bego, *Albania*, 60.

<sup>15</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 15.

<sup>16</sup> Serbët, malazezët dhe gregët përshkruhen si pushtuesë, barbarë, si një kërcënim për kombin shqiptar. Bego, *Albania*, 61.

<sup>17</sup> Bego, *Albania*, 59.

*Ushtrisë Kombëtare Shqiptare*, një organizatë e EDHKD-së e cila operon në Shqipëri, Greqi, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe në Serbi me qëllim të krijimit të Shqipërisë së Madhe.<sup>18</sup>

Idetë e ekstremistëve të krahut të djathtë janë të pranishme online, kurse diaspora konsiderohet si një aktor i cili po ashtu luan një rol në radikalizimin. Marrë në përgjithsi, narrativi i EKD-së mbindërton racizmin kundër romëve dhe migrantëve. Njëlloj si me vendet e Ballkanit Perëndimor, përmbajtja e tyre online përfshinë teori kundër komunizmit, revizionizmit historik, ksenofobisë, antisemitizmit, racizmit dhe konspiracionit.<sup>19</sup> Po ashtu edhe tifozët ekstremistë të futbollit promovojnë EKD-në. Për shembull, tifozët e sportit, *Tirona Ultras* haptazi përdorin simboledhe mesazhe fashiste ose naziste në stadium, të cilla si banderola të SS Divizionit Skenderbeg. Mjaft aktivë janë edhe në media sociale, ku bëjnë promovimin e nazizmit dhe revizionizmit historik.<sup>20</sup> Skepticizmi lidhur me BE-në dhe pakënaqësia me tentativat e qeverisë për të krijuar institucione demokratike edhe më tej u shfrytëzua nga ekstremistët e krahut të djathtë, duke promovuar haptazi qëndrime kundër BE-së, kundër SHBAve, pro Trampit dhe pro Rusisë.

Trajtimi i EDHKD-së kërkon disiminimin me kujdes të historisë destruktive të fashizmit dhe komunizmit, si dhe trashigimia e saj të detektohet dhe t'i komunikohet publikut, përfshirë këtu edhe përdorimin e platformave online dhe televizionin. Publiku, sidomos diaspora dhe rrinua në rrezik, duhet të njoftohet për potencialet e neofashizmit, të cilët përfshijnë edhe rekrutimin online dhe strategji të radikalizimit. Çështje e brishta të minoritetit grek në Shqipëri, si dhe marrëdhëniet Kosovë\*-Serbi ende kanë potencial të mobilizojnë mbështetje për EKD-në.<sup>21</sup> Format rajonale të bashkëpunimit të tilla si bashkëpunimi arsimor dhe ekonomik, mund të zbusin distancën me partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor bazuar mbi dallimet historike dhe kulturore. Pakënaqësia me orvatjet e qeverisë për të ndërtuar institucione demokratike dhe për të adresuar çështje ekonomike, shëndetsore dhe ato të migrimit si dhe krinimin e organizuar po ashtu lë hapësirë për potencial të EDHKD-së. Sundimi i së drejtës dhe perspektivat e anëtarësimit në BE mund të luajnë një rol vendimtar në këtë drejtim.<sup>22</sup>

#### **b. Bosnja dhe Hercegovina**

Lufta në BiH mbaroi në nëntr 1995, por pasojat e saj ende i godasin qytetarët e BiH-së.<sup>23</sup> Mungesa e konsensusit lidhur me narrativet e së kaluarës, mosmarrëveshjet e shpeshta politike, problemet e rëndësishme ekonomike dhe ndikimet e ndryshme të huaja janë kriqëzuar dhe më tej i kanë intensifikuar tensionet dhe polarizimet ndëretnike dhe politike.<sup>24</sup> Kjo e ka bërë shoqërinë e BiH shumë të cenushme ndaj nacionalizmit etnik, ndar radikalizimit politike si dhe ndaj ekstremizimit ideologjik.<sup>25</sup> Ashti siç ceket në Raportin e Komisionit Evropian mbi Bosnjën dhe Hercegovinën 2021:

"Përkushtimi publik politik i autoriteteve në të gjithë nivelet e qeverisë ndaj qëllimeve strategjike të integritimit evropian nuk mori formë konkrete, pikërisht për shkak se prijësit politikë nuk reshtën me retorikën e tyre ndarëse dhe me debatet e tyre jokonstruktive."<sup>26</sup>

<sup>18</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 15.

<sup>19</sup> Bego, *Albania*, 59-61.

<sup>20</sup> Bego, *Do Albanians like Fascism? An Iconographical Investigation on Social Media Material*.

<sup>22</sup> Komisioni Evropian, *Raporti mbi Shqipërinë 2021*

<sup>23</sup> Turčalo & Veljan, *Community Perspectives on the Prevention of Violent Extremism in Bosnia and Herzegovina*, 2; Buljubašić, *Predetermined for war? A trace of intergenerational transmission of war legacies among ethnically divided postwar generation from Bosnian urban areas*, 77-94.

<sup>24</sup> Bećirević, *Bosnia and Herzegovina report*, 5.

<sup>25</sup> Më shumë informacion mbi Bosnjën dhe Hercegovinën, përfshirë edhe angazhimin e vendit kundër ekstremizmit të dhunshëm, mund të gjendet në raportin vijues për vendin në fjalë të Komisionit Evropian: *Raporti mbi Bosnjën dhe Hercegovinën 2021. 2021 Komunikatë mbi politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Versionin në gjuhë angleze e gjeni këtu: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/bosnia-and-herzegovina-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/bosnia-and-herzegovina-report-2021_en).*

<sup>26</sup> *Raporti i Komisionit Evropian mbi Bosnjën dhe Hercegovinën 2021*, 3.

Spektri ideologjik i ekstremizmit të krahut të djathtë i BiH kryesisht ndahet sipas etnicitetit dhe përfshin lëvizjet ultranacionaliste, neofashiste dhe neonaziste.<sup>27</sup> Narrative më domonuese të këtyre grupeve kanë të bëjnë me nacionalizmin fetar, homofobinë, antisemitizmin, islamofobinë dhe revizionizmin historik. Aktivitetet e tyre nuk janë shumë të shquara. Politikisht nuk janë aktiv dhe lidhjet e tyre të hamendësuar me partitë politike nacionaliste nuk janë provuar.<sup>28</sup> Këto grupe përfshijnë huliganët e tifozërisë dhe shembujt më të spikatur janë ultratifoza etnik kroat nga Mostari dhe tifozët serb nga Prijedor. Në Mostar, Zrinski Ultras- disa prej të cilëve janë anëtarë të Skinheads Mostar (Kokërruarit e Mostarit) - në mënyrë evidente mbështesin neonazizmin dhe kanë lidhje me organizatën e EDHKD-së të Ukrainës, të njohur si Azov.<sup>29</sup> Në Prijedor, *Rudar Ultras* kanë karakteristika të ngjashme me homologët e tyre nga Mostari. Këto kanë lidhje me organizatat serbe të ekstremizmit të krahut të djathtë dhe kanë vijuar kampe të EDHKD-së në Rusi.<sup>30</sup> Përveç kësaj, *Lëvizja Boshjake e Krenarisë Kombëtare* synon shtetin e pastër boshnjak.<sup>31</sup> Promvojnë ide homofobike, antisemitike, antimuslimane dhe antikomuniste,<sup>32</sup> si dhe kanë lidhje me lëvizje të ngjashme në Ukrainë dhe Skandinavi.<sup>33</sup>

Disa organizata ekstreme të krahut të djathtë operojnë si organizata joqeveritare (NGO) zyrtarisht të regjistruara në Republika Serbska, duke shprehur tendencat antiqeveritare ndërkohë që mbrojnë bashkimin kombëtar dhe puritetin ose partëtrinë etnike, të tilla si *Lëvizja Çetnike*. Narrativi i tyre mbështet mbi irridentizmin, revizionizmin historik, kremtimin e kriminelëve të luftës, dhe mbi përhapjen e emocioneve ose sentimenteve antikriate, antimuslimane dhe antikomuniste. Të gjithë bashkëpunojnë ngusht me ekuivalentët e tyre nga Mali i Zi, Serbia dhe përtej, si dhe kanë lidhje të ngusht me kishën ortodokse serbe, organizatat e veteranëve të luftës, dhe me organizata dhe individë të ndryshëm të ekstremizmit të krahut të djathtë. Tubimet çetnike në Republika Serbska karakterizohen me rituale militariste, refuzimin e gjenocidit të Srebrenicës, glorifikimin e kriminelëve të luftës dhe me portretizimin e nacionalistëve etnikë dhe ikonografinë fashiste.<sup>34</sup> Anëtarët e tyre kanë lidhje të ngushta me EDHKD-në të përfshirë në luftën e Ukrainës. Së paku 11 qytetarë të BiH luftuan në Ukrainë para konfliktit të armatosur të vitit 2022,<sup>35</sup> por çështjet procedurale, të cilla si mbledhja e provave, e bëjnë të vështirë zhvillimin e procedimeve penale.<sup>36</sup> Ekstremistët rusë dhe ato serb të krahut të djathtë kanë filiale zyrtare dhe jozyrtare si dhe anëtarë nga Republika Serbska e BiH. Shembuj rusë janë Night Wolves (Ujqrit e Natës) të cilët kanë lidhje të ngushta me Putinin<sup>37</sup> si dhe skenën politike serbe në BiH.<sup>38</sup> Mbështetje ruse për organizatat dhe aktivistët serb ekstremistë të krahut të djathtë është shumëdimensionale dhe shtrihet nga mbështetje për të përfunduar aktivitete (online) e deri te trajnimi ushtarak.<sup>39</sup> Luftarët rusë nga Ukraina veproun si instruktor ose tutorë në kampet për trajnimin e të rinjve në Rusi dhe Serbi, ku morën pjesë fëmijë nga Republika Serbska e BiH.<sup>40</sup> Përveç kësaj, disa organizata serbe të ekstremizmit të dhunshëm të krahut të djathtë si *Kozakët Serb (Serbian Cossacks)*<sup>41</sup> dhe organizatat EKD-së si *Nderi Serb (Serbian Honour)* kanë anëtarë dhe veprojnë në BiH. Organizatat e EKD-së të cilat janë themeluar dhe veprojnë në entitetin e Republika Serbska kanë një paradigmë të ngjashme: financim të errët, nacionalizëm ortodoks krishter, mbështetje proruse, homofobi, militarizëm dhe revizionizëm historik. Disa, si Shën Gregori Loncari, operojnë nën petkun e humanitarizmit.<sup>42</sup>

Pjesa dërmuese e aktiviteteve të ekstremistëve kroat të krahut të djathtë gjejnë shprehje mes individëve dhe grupeve joformale, kryesisht online, nëpërmjet ueb portaleve dhe rrjeteve të ndryshme sociale.

<sup>27</sup> Organizata të cilat promovojnë ideologjinë neonaziste janë *Lëvizja Boshnjake e Krenarisë Kombëtare*, *Gjak dhe Nder*, filialet e tyre *Beteja 18* dhe *Kokërruarit e Mostarit*.

<sup>28</sup> Kuloglija, *Bosnia & Herzegovina*, 65.

<sup>29</sup> Kuloglija, *In Bosnian River Town, Far-Right Symbols and a Link to Ukraine*.

<sup>30</sup> Kuloglija, *Ultra-Right Groups Show Their Face in Bosnian Town*.

<sup>31</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 10.

<sup>32</sup> Kuloglija, *Bosnian Far-Right Movement Weds Bosniak Nationalism, Neo-Nazism*.

<sup>33</sup> Milekic et al., *Far-Right Balkan Groups Flourish on the Net*.

<sup>34</sup> Veljan & Čehajić, *A Dangerous Nexus? History, Ideology and the Structure of the Contemporary Chetnik Movement*, 22-40.

<sup>35</sup> Obrenović, *Novi zov rata u Ukrajini za dobrovoljce iz BiH i Srbije*.

<sup>36</sup> Bećirević, *Bosnia and Herzegovina report*, 12.

<sup>37</sup> Losh, *Putin's Angels: the bikers battling for Russia in Ukraine*.

<sup>38</sup> Mujkić, *Bosnian Branch of 'Putin's Angels' Enjoys Political Backing*.

<sup>39</sup> Mujkić, *Ukraine War Veterans Bind Russia and Bosnian Serbs*.

<sup>40</sup> Mujkić, *How Russian Fighters Train Serb Teens at 'Military-Patriotic' Camps*.

<sup>41</sup> Obrenovic, *Under Cossack Banner, Russian Ties with Balkan Fighters Strengthened*.

<sup>42</sup> Pekmez, *Black-Clad 'Humanitarians' Promote Pro-Russian Agenda in Bosnia*.



Ekstremizmi kroat i krahut të djathtë bartet nga Kroacia fqinje te kroatët etnike në BiH. Kjo është luftë me revizionizmin historik, të tillë si Lufta e II Botërore ose luftat e 1990-ve,<sup>43</sup> karakterizohet me homofobi, islamofobi, ksenofobi dhe glorifikim të krimeve të luftës, dhe ka një urrejtje të theksuar të feminizmit, barazisë gjinore dhe abortit, përfshirë këtu edhe kundërthëniet me fenë dhe institucionet fetare.<sup>44</sup> Së paku 20 individë nga BiH dhe Kroacia vullnetarisht iu bashkëngjitën Batalionit Azov të EDHKD-së në Ukrainë para konfliktit të armatosur të vitit 2022.<sup>45</sup>

Midis agjencive të sigurimit në BiH, komunikimi dhe koordinimi duhet të përmirësohet, kurse sundimi më i mirë së drejtës dhe një vullnet i hapur politik për adresimin e EKD-së do të jenë arritje të rëndësishme.<sup>46</sup> Politikat që synojnë parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDHKD-së janë të nevojshme, po ashtu edhe kontroll efektive mbi përmbajtjet online.<sup>47</sup> Zyrtarët publikë duhet të arrijnë një mirëkuptim më të mirë lidhur me nevojën për të trajtuar këto dukuri, dhe po ashtu duhet të zbatohen masa të veçanta trajnimi për sektorë të ndryshëm, si gjyqësia, përforcimi i së drejtës dhe organe të tjera të sigurisë. Në BiH, lokomotiva për EDHKD potenciale qëndron thellë në kontekstin kompleks politik i cili përfshinë ndërthurjen e politikës, nacionalizmin fetar,<sup>48</sup> polarizimin ndëretnik dhe çështjet e pazgjidhura të së kaluarës.<sup>49</sup>

Duke fuqizuar rolin e gruas, sidomos në procesin e vendimmarrjes dhe duke mbështetur media të pavarura, simpatitë ndaj EKD-së mund të zbuten.<sup>50</sup> Orvatjet ose tentativat e tranzicionit në gjyqësor, përfshirë aktivitete për ndërtimin e paqës dhe pajtimit, duhet të ristrukturohen dhe përshtaten në përputhje me P/KEDH. Në vend të angazhimit të popullatës së përgjithshme rrinia e cila është rrezik nga EDHKD-ja të zgjidhet me kujdes dhe të përfshihet në aktivitete, si vizita edukative në hapësira ku mbizotërojnë kryesisht grupe të tjera etnike.

### c. Kosova\*

Realiteti socio-politik dhe kushtet jetësore në Kosovë kanë ndryshuar pas luftës ka fundi i viteve 1990-ta. Është shënuar progres drejt shtegut të BE-së.<sup>51</sup> Por, sërish vendi ballafaqohet me perceptime të orvatjeve të dështuara të lidhshpimit të tyre, me papunësi dhe korrupsion.<sup>52</sup> Sipas grupit të fokusit të Kosovës të Institutit Kombëtar Demokratik, nga viti 2016, Adrian Shtuni, një specialist i politikës dhe sigurisë së jashtme, shtoi se:

"Pjesëmarrësit shprehën se kanë shumë pak besim në shumicën e institucioneve qeveritare, dhe kryesisht i perceptonin ato si të korruptuara, egoiste dhe të paafta për adresimin e çështjeve të rëndësishme për qytetarët e zakonshëm."<sup>53</sup>

Çështjet e krimit të organizuar, papunësia dhe përhapja e frikës se BE nuk u del për zot interesave të shqiptarëve mund të iniciojë rritjen e EKD-së. Por, studimet të cilat analizuan faktorët e rrezikut të cilët mundësojnë paraqitjen e ekstremizmit kanë gjetur që një kombinim i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm<sup>54</sup> dhe pritshmëritë e paplotësuara janë një faktorë më mbështetës i ekstremizmit se sa vetëm privimi ekonomik.<sup>55</sup> Nacionalizmi agresiv i cili përfundimisht na shpeu te konflikti i armatosur vazhdon të

<sup>43</sup> Colborne, *Croatia Key to Ukrainian Far-Right's International Ambitions*.

<sup>44</sup> Veljan & Cehajic-Campara, *Gender Ideologies: How Extremists Exploit Battles over Women's Rights and Drive Reciprocal Radicalisation*.

<sup>45</sup> Colborne, *Croatia Key to Ukrainian Far-Right's International Ambitions*.

<sup>46</sup> Kuloglija et al., *Balkan States Failing to Address Threat from Far-Right Extremism*.

<sup>47</sup> Kuloglija, *In Bosnian River Town, Far-Right Symbols and a Link to Ukraine*.

<sup>48</sup> Bećirević, *Bosnia and Herzegovina report*, 44-45.

<sup>49</sup> Hone, *How Ethnic and Religious Nationalism Threaten the Bosnian State*, 58-77.

<sup>50</sup> Atlantic Initiative, *Countering Violent Extremism Baseline Program*.

<sup>51</sup> Më shumë informacion mbi Kosovën, përfshirë edhe angazhimin e vendit kundër ekstremizmit të dhunshëm, mund të gjendet në raportin vijues për vendin në fjalë të Komisionit Evropian: *Raporti mbi Kosovën\* 2021. 2021 Komunikatë mbi politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian. English language available here: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en).*

<sup>52</sup> Beha & Selaci, *Statebuilding without Exit Strategy in Kosovo*, 97-124.

<sup>53</sup> Shtuni, *Dynamics of Radicalization and Violent Extremism in Kosovo*.

<sup>54</sup> Kraja, *Cultural Drivers of Radicalisation*.

<sup>55</sup> Denoeux & Carter, *Guide to the Drivers of Violent Extremism*.

rëndojë shqoërinë e pas luftës në Kosovë.<sup>56</sup> Narrativet e EKD-së të ndërtuara me religjionin ende luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e politikave të Serbisë ndaj Kosovës. Duhet theksuar se EKD-së në Kosovë ndahet sipas linjave etnike dhe kryesisht mbështetet mbi politikat e identitetit dhe ato të ultranacionalizmit. Edhe pse BE-ja ndimoi normalizimin e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë,<sup>57</sup> radikalizimi i EKD-së, në formë të ngjashme si në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, kryesisht është reciprok dhe nga lartë-poshtë; ndjeja e kërcënimi, e frikës dhe e mosbesimit midis grupeve etnike në vete ngërthen potencialin e shpërthimit të EKD-së.

EKD-ja shqiptare karakterizohet me ndjenjat lidhur me pavarësinë e Kosovës dhe në aspekt rajonal përfshinë shqiptarët etnik në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Edhe pse ideja e bashkimit të "trojeve shqiptare" përmban një joshje emocionale, sërish kjo është e brishtë si ide dhe nuk gëzonë mbështetje të madhe në popull. Organizatat e EKD-së të cilat avokojnë ose mbështesin Shqipërinë e Madhe janë me ndikim marginal. Por kjo nuk nënkupton se një ide e tillë eksresmite e krahut të djathë nuk duhet të merret si një kërcënim i mundshëm.<sup>58</sup> Lëvizjet serbe të EDHKD-së e konsiderojnë Kosovën si një enklavë e vogël brenda Serbisë: e ashtuquajtur *Zemra historike e Serbisë*. Pjesa dërmese e serbëve ekstremistë të krahut të djathtë kanë bërësuar qëndrimin se shqiptarët janë "armiçë të rrezikshëm" që kërkojnë krijimin e Shqipërisë së Madhe dhe i konsiderojnë shqiptarët ardhacak. Kanë lidhje të ngushta me organizata dhe aktivistë ndërkombëtar të EKD-së.<sup>59</sup>

Startegjia Kombëtare e Kosovës kundër terrorizmit dhe Plani i veprimit e njeh EKD-në si formë ekstremizmi me motive dhe mekanizma nacionaliste dhe politike për K/PEDH të tilla si koordinimi dhe kontrolli institucional i individëve dhe grupeve të cilët paraqesin një kërcënim potencial terrorist. Megjithatë, metodat institucionale dhe joqeveritare ndaj K/PEDH janë më shumë të dedikuara ndaj ekstremizmit islamik.<sup>60</sup> Qasja e Kosovës është qasje bashkëpunuese dhe koordinuese me OJQ-të dhe institucionet fetare për parandalimin e EDHKD-së.<sup>61</sup> Edhe pse marrëdhëniet ndëretnike kanë shënuar përparim vitet e fundit, ata vazhdojnë të mbetetn një sfidë. Retorika dhe aktivitetet formësojnë një dynamikë komplekse lokale ndëretnike dhe ngacmojnë simpati për EDHKD-së. Sulmet dhe incidentet me motive etnike si dhe mungesa e reagimit të duhur institucional janë faktorë që bashkërisht e nxisin radikalizimin.<sup>62</sup> Andaj, çdo aktivitet për ndërtimin e paqes, pajtimit dhe aktivitete të ngjashme duhet të rishpiken dhe të përshtaten sipas sfidave lokale të EKD-së. Profesionistët - përfshirë zyrtarë publikë si dhe shërbimet e sigurisë - do të përfutojnë nga trajnimet që synojnë përmirësimin e kapacitetit për të detektuar shenjat e hershme të radikalizimit dhe EDHKD-së në bashkësitë lokale, dhe mund të stërviten për një qasje objektive për trajtimin e qytetarëve pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Negociatat dhe përmirësimet e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë mund të zbusin EKD-së në Kosovë.<sup>63</sup> Ngërçi i pazgjidhur midis Kosovës dhe Serbisë mbetet mes kërcënimeve më të mëdha për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor.<sup>64</sup>

#### d. Mali i Zi

Dy dekadat e fundit, Mali i Zi në përgjithsi ka shënuar progresin në drejtim të antarësimit në BE,<sup>65</sup> por rrethanat politike në Malin e Zi ngadal u bënë thellësisht jostabile dhe nacionalizmi etnik ka qenë në rritje. Menjëherë para se Mali i Zi të fitojë pavarësinë nga Federata e Serbisë dhe Malit të Zi në vitin 2006, polarizimi dhe radikalizimi serb dhe ai malazez ngadal filloi të shfaqet. RKD-ja serbe në Mali të Zi karakterizohet me revizionizëm historik, polarizim politik, roli që luajnë institucionet fetare në jetën publike

<sup>56</sup> Biserko, *Yugoslavia's Implosion: The Fatal Attraction of Serbian Nationalism*.

<sup>57</sup> European Commission Staff, *Kosovo\* 2021 Report*, 3.

<sup>58</sup> Janjevic, *Greater Albania - bogeyman or a pipe dream?*

<sup>60</sup> European Commission Staff, *Kosovo\* 2021 Report*, 44-45.

<sup>61</sup> Ministry of Internal Affairs, *National Strategy against Terrorism and Action Plan 2018–2023*.

<sup>62</sup> PAVE, *Focus-group in North Mitrovica with the Serbian community to examine the issue of online and offline (de) radicalization*.

<sup>63</sup> Office of the Prime Minister, *Strategy for the prevention of violent extremism and radicalism that leads to terrorism 2015–2020*.

<sup>64</sup> Congressional Research Service, *Kosovo: Background and U.S. Policy*.

<sup>65</sup> Më shumë informacion mbi Malin e Zi, përfshirë edhe angazhimin e vendit kundër ekstremizmit të dhunshëm, mund të gjendet në raportin vijues për vendin në fjalë të Komisionit Evropian: *Raporti mbi Malin e Zi 2021. 2021 Komunikatë mbi politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Versionin në gjuhë angleze e gjeni këtu: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/montenegro-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/montenegro-report-2021_en).*

dhe ekspansioni i reorikës së dhunshme në hapësira publike. Hapësira online, sidomos rrjete sociale, luajnë një rol shumë të rëndësishme në radikalizimin e EKD-së në Mal të Zi.<sup>66</sup> Në rrjetet sociale, sidomos në Facebook, ithtarët e ideolojive të EKD-së tubohet në grupe dhe faqe të ndërlidhura. Këto aktivitete online kanë pasoja edhe në jetën reale. Duhet të ceket se shumë qytetarë përligjin dhunën si reagim ndaj padrejtësisë ose si masë për të mbrojtur fenë e tyre.<sup>67</sup>

Mali i Zi është një vend shembullor se si radikalizimi i EKD-së në Ballkanin Perëndimor mund të kuptohet nëpërmjet dinamikave dhe lëvizjeve rajonale dhe gjeopolitike në shkallë më të gjerë.<sup>68</sup> Periudha para anëtarësimit të Malit të Zi në NATO karakterizohet me ndikim më të madh rus. Me kalimin e moteve, marrëdhëniet shumë të mira me Rusinë u përkeqësuan, Mali i Zi kishte një trajektore të paepur drejtë anëtarësimit në NATO dhe qeveria mbështeti saknionet e BE-së kundër Rusisë në vitin 2014. Pasi qasja ose anëtarësimi i Malit të Zi në NATO ishte evidente në vitin 2015,<sup>69</sup> EKD-ja filloi të rritet dukshëm mes serbëve etnik.<sup>70</sup>

Në vitin 2015, u themelua një filiale e klubi rus të motoçklistëve, i njohur me emrin *Ujqërit e Natës*. Në vitin 2016, u themeluar *Ushtria Kozake e Ballkanit* në Kotor. Këto grupe kanë narrative të ngjashme që kremtojnë kriminelë të luftës dhe revidime të historisë dhe kanë ndjenja të përbashkëta ortodokse. Ashtu siç ishte rasti në BiH dhe Serbi, po ashtu edhe në Mal të Zi kishte *Lëvizje Çetnike*, e cila kishte lidhje rajonale.<sup>71</sup> Me fillimin e anëtarësimit të Malit të Zi në NATO në vitin 2017, kriza e brendshme politike edhe më tej përqësoi rrethanat politike dhe nxiti e EKD-së. Aktivitete e EKD-së të mbështetura dhe të përzijera nga armiqësitë proruse dhe proserbe u intensifikuan pas një grusht shteti të tentuar në vitin 2016. Grusht shteti përbëhej nga 2 rusë dhe 20 serbë, disa prej të cilëve kishin të lidhje me luftën e Ukrainës<sup>72</sup> dhe shërbimet e sigurisë së jashtme.<sup>73</sup> Qëllimi i tyre ishte, siç thuhej, të vrasin kryetarin etnik malazez dhe të marrin pushtetin.<sup>74</sup> Në vitin 2020, pas formimit të qeverisë proserbe në Mali të Zi, Gjykata Supreme liroi të gjithë të akuzuarit në vitin 2021 për shkak të shkeljes së procedurave penale.<sup>75</sup>

Qeveria e Malit të Zi në vitin 2018 filloi procesin e adoptimit të ligjit mbi religjionin duke synuar regjistrimin e pronës dhe të vendeve fetare të cilat ishin në pronësi të Mbretësisë së Malit të Zi para se ajo me dhunë të bëhej pjesë e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, kryesisht të dominuar nga serbët, në vitin 1918. Vendimi përforcojë ndarjet ndëretnike. Kisha ortodokse shprehi reagimin e saj duke mobilizuar serbët në Mal të Zi dhe vendet fqinje - Serbi, BiH dhe Kosovë - duke përfshirë politikanët më të shquar për një kauzë e cila do të cimentojë marrëdhëniet ndëretnike. Nën petkun e "Të shpëtojmë faltoret serbe" kisha serbe ortodokse shfrytëzoi cenueshmëritë e shoqërisë malazeze të cilat nxitën EKD-së. Grupet vendase dhe rajonale, si dhe mbështetja nga organizatat e huaja të EKD-së si Ujqëritë e Natës dhe Kozakët rus, në mënyrë të hapur mbështesin dhjetëra mijëra protestues të besimtarëve të kishës serbe.<sup>76</sup> Shumë grupe jofromale të EKD-së dolën nga kjo protestë, si Shtyllat e Vllazërisë Ortodokse, të cilat misionin e tyre e përshkruajnë si patriotik dhe human ndërkohë që operojnë me ikonografi, e cila është karakteristike për grupet EKD-së; po ashtu, disa aktivistë të EKD-së iu kthyen aktivitetit politik.<sup>77</sup> Përveç kësaj, kisha serbe nuk i fsheh lidhjet e saj me aktivistët dhe grupet e ekstremizimit të krahut të djathtë (EKD).<sup>78</sup> Sa i përket luftës së Ukrainës, pesë serbë etnik u akuzuan për luftë të huaj në anën proruse para konfliktit të armatosur të vitit 2022, por vetëm njëri prej tyre u dënua, kurse të tjerët ikën, me siguri në Serbinë fqinje.<sup>79</sup>

Aktivitete e ekstremizimit të krahut të djathtë vazhdojnë të rriten online nëpërmjet mediave të ndryshme sociale. Faqet meme, bashkë me llogaritë e tjera sociale të ekstremizimit të krahut të djathtë, formuan një rrjet komunikimi në fushatën zgjedhore gjatë zgjedhjeve të vitit 2020. Këto rrjete promovojnë rëndësinë e

<sup>66</sup> Jovanovic, *Call to Lynch: The War of Words Threatening Montenegro's Delicate Balance*.

<sup>67</sup> Papović & Kovačević, *Rast desničarskog ekstremizma u Crnoj Gori: Građanska država na ispitu*, 14, 26-27.

<sup>68</sup> Morrison, *Nationalism, Identity and Statehood in Post-Yugoslav Montenegro*.

<sup>69</sup> Morrison, *Nationalism, Identity and Statehood in Post-Yugoslav Montenegro*.

<sup>70</sup> BIRN, *Montenegro: Key Political Parties*.

<sup>71</sup> Papović & Kovačević, *Rast desničarskog ekstremizma u Crnoj Gori: Građanska država na ispitu*, 26-27.

<sup>72</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 14.

<sup>73</sup> Radio slobodna Evropa, *Ukinuta presuda za 'državni udar' u Crnoj Gori, DPS tvrdi rezultat pritiska na sud*.

<sup>74</sup> Tomovic, *Key Witness in Montenegro 'Coup' Trial to Testify*.

<sup>75</sup> Apelacioni sud Crne Gore, *Saopštenje za javnost povodom predmeta "Državni udar"*; European Commission Staff, *Montenegro 2021 Report*, 46.

<sup>76</sup> Zivanovic, *Russian 'Night Wolves' Bikers Support Montenegro Church Protests*.

<sup>77</sup> Papović & Kovačević, *Rast desničarskog ekstremizma u Crnoj Gori: Građanska država na ispitu*, 26-27.

<sup>78</sup> Rudic, *Montenegro Detains Pro-Putin Bikers Escorting Serbian Patriarch*.

<sup>79</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 14.

religjionit, simbolet kombëtare serbe, kishën dhe vlerat, irridentizmin, maskularitetin toksik dhe armiqësitë ndaj grupeve të tjera etnike.<sup>80</sup> Pasojat e provokuara nga ekstremistët e krahut të djathtë shtrihen përtej konfliktit të thejstë idologjik ndëretnik midis malazezëve dhe serbëve. Për shembull, pas zgjedhjeve të vitit 2020 u vërejtë rritje e islamofobisë dhe e incidenteve kundër muslimanëve në tërë vendin.<sup>81</sup>

Pas humbjes së fuqisë politike dhe me lëvizje të indinjatës së nacionalistëve dhe klerikëve serb, u themelua partia politike promalaze ekstremiste e krahut të djathtë - *Bashkimi i Komitave Patriotik të Malit të Zi (Komitas)*. Në fillim të vitit 2021, Komitas morën përgjegjësinë për sulmet në kabinetin e ri malazez.<sup>82</sup> Me arrdhen në fron të priftërinjëve të kishës serbe së fundmi në kryeqytetin e vjetër mbretëror të Malit të Zi - Cetinje - u bë strofullë e re për vazhdimin e EKD-së midis grupeve etnike.<sup>83</sup> Në të dyja anët, individët të cilët anonin ka EDHKD-së në terren janë tifozë nga Mali i Zi dhe Serbia.<sup>84</sup>

Nuk ka politika dhe aktivitete të P/KEDH-së të cilat trajtojnë EKD-në, kurse rreziqet që përkisnin me format të tilla të eksremizmit nuk trajtohen siç duhet.<sup>85</sup> Incidentet e motovuara nga urejtja etnike ose fetare trajtohen si kundërvajtje. Ministria e Brendshme e Malit të Zi ndaloi lëvizjen çetnike sepse ata paraqesin një rrezik sigurie, por kjo ndalesë nuk çrrënjosi rrjetin e aktiviteteve të lëvizjes; thjeshtë zhvendosën aktivitetet e tyre nëntokë.<sup>86</sup> Radikalizimi online i EKD-së është çështje madhore,<sup>87</sup> por një kornizë e dobët e kontrollit të informacionin online pengon veprimin e autoriteteve zyrtare.<sup>88</sup> Nëse do të trajtoheshin dhe do të mbështeteshin, OJQ-të dhe mediat e pavarura mund të bëhen një mjet i rëndësishëm për trajtimin e narrativeve latente online të cilat mund të na shpien te radikalizimi i EKD-së. Ndërkohë që shërbimet sekrete krijuan një njësi për radikalizim si dhe një skuadër për përndjekjen e përmbajtjes online që ka të bëjë me terrorizmin dhe eksremizmin e dhunshëm, EDHKD-ja ka qenë në margjinat politike dhe mediatike.<sup>89</sup>

#### e. Maqedonia e Veriut

Dy dekadat e fundit, Maqedonia e Veriut ka zbatuar një numër të konsiderueshëm të referomave, përfshirë këtu masat për prevendimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Por, EKHD-ja si duket është lënë pas dore. Prioritizimi i rreziqeve dhe qëndrueshmëria për kundërvënie dhe/ose prevenim të EKD-së duhet të pranohet dhe të përmirësohet.<sup>90</sup> Pas shembjes së Jugosllavisë, marrëdhëniet midis maqedonasve dhe shqiptarëve u përkeqësuan nga ndjenja e përhapur e kërcënimit dhe fyerjeve të cilat përfundimisht na shpyen te disa epizoda të radikalizimit dhe dhunës. Në vitin 2001, konflikti afatshkurtër i armatosur në rajonin veri-perëndior të vendit përfundoi me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit e cila garantonte të drejta politike dhe kulturore për shqiptarët. Shoqëria e Maqedonisë së Veriut vazhdoi të mbetej e polarizuar me incidente lokale dhe sekuencat e dhunës vazhduan. Polarizimi shtesë politik u shfaq pas zgjedhjeve të 2014, dhe rezultoi në protesta kundër sundimit antidemokratik dhe korrupsionit të supozuar. Në vitin 2017, aktivistët ekstremist të krahut të djathtë (EKD) në Maqedoninë e Veriut, sulmuan parlamentin si reagim ndaj zgjedhjeve të një shqiptari etnik si zëdhënës i kuvendit. Ashtu si në raste të tjera, radikalizimi në Maqedoninë e Veriut mund të kuptohet vetëm nëse hulumtohet dinalima më e gjerë rajonale dhe gjeopolitike.

Një gamë e ngjarjeve ka ndikuar radikalizimin e ekstremistëve të krahut të djathtë të Maqedonisë së Veriut si dhe ndjenjat e tyre më shumë proruse, anti-NATO dhe anti-BE. Marrëdhëniet e këqija me Greqinë (duke ndikuar anëtarësimin në NATO) zgjatën deri në vitin 2018, kurse marrëdhëniet me Bullgarinë ndikuan procesin e anëtarësimin në BE në 2020. Ekstremistët e krahut të djathtë të maqedonasëve etnik kanë

<sup>80</sup> Vujanović, *Mim stranice kao lideri javnog mnjenja u izbornoj kampanji za parlamentarne izbore u Crnoj Gori 2020. godine*. Morrison, *Nationalism, Identity and Statehood in Post-Yugoslav Montenegro*.

<sup>81</sup> The Atlantic Initiative Team, *Muslims in Montenegro after the Elections, and Fear of the Future*; Karcic, *Separatism reloaded: How did Montenegro end up in limbo?*

<sup>82</sup> Jovanovic, *Call to Lynch: The War of Words Threatening Montenegro's Delicate Balance*.

<sup>83</sup> Kajosevic, *Serbian Church Leader's Enthronement Raises Tensions in Montenegro*.

<sup>84</sup> Voice of America, *Montenegro Denounces Protest Attack on Embassy in Serbia*.

<sup>85</sup> Kuloglija et al., *Balkan States Failing to Address Threat from Far-Right Extremism*.

<sup>86</sup> Papović & Kovačević, *Rast desničarskog ekstremizma u Crnoj Gori: Građanska država na ispitu*, 26.

<sup>87</sup> European Commission Staff, *Montenegro 2021 Report*, 45.

<sup>88</sup> Jovanovic, *Call to Lynch: The War of Words Threatening Montenegro's Delicate Balance*.

<sup>89</sup> Bećirević et al., *Radicalisation and violent extremism in the Western Balkans*, 17-18.

<sup>90</sup> Më shumë informacion mbi Maqedoninë e Veriut, përfshirë edhe angazhimin e vendit kundër ekstremizmit të dhunshëm, mund të gjendet në raportin vijues për vendin në fjalë të Komisionit Evropian: *Raport mbi Maqedoninë e Veriut 2021 2021 Komunikatë mbi politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Versionin në gjuhë angleze e gjeni këtu: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en).*

ndjejnja të fuqishme kundër shqiptarëve, kundër grekëve, kundër bullgarëve dhe ndonjëherë edhe kundër serbëve, kurse ekstremizimi i krahut të djathtë ka ndjenja të fuqishme kundër maqedonasëve dhe serbëve. Vetëm grupet neonaziste janë kundër semitizmit.<sup>91</sup> EKD-ja e Maqedonisë kryqëzohet edhe me religjionin.<sup>92</sup> Disa organizata ekstreme, si *Vëllazëria Kristere Maqedonase*, promovojnë dhunë nëpërmjet simbileve dhe përdorimit të retorikës ushtarake dhe gjuhës së urretjes.<sup>93</sup>

Përveç kësaj, *Organizata Maqedonase Kombëtare për Rikonstrukcion Radikal - Vardari, Egjeu, Pirini* shfrytëzon lëvizjen historike çlirimtare si kredencë dhe synon një Maqedoni etnikisht të pastër.<sup>94</sup> EKD-ja e Maqedonisë ka qëndrime pozitive ndaj Izraelit sepse e konsiderojnë traktimin e tyre të perceptuar të palestinezëve si model i dëshiruar për traktimin e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.<sup>95</sup> *Lëvizja Popullore e Maqedonisë* ndjek një model të ngjashëm; është kundër Marrëveshjes së Ohrit dhe ka një agjendë me ekspansion territorial e cila daton që nga periudha para vitit 1913. Po ashtu promovojnë teori konspirative dhe synojnë madje edhe raportin ankesa penale kundër individëve të cilët shihen si armiqë të shtetit. *Kongresi Botëror Maqedonas* promovonë politikën e identitetit e cila ngre rëndësinë historike maqedonase të tillë si ideja që Maqedonia e Veriut është djepi historik i civilizimit Evropian. Këto organizata kanë ndikim marginal, por kanë disa interesa të përbashkëta dhe gëzojnë mbështetje nga aktivistët e krahut të djathtë.<sup>96</sup> Këto grupe përdorin media sociale për propagandë, ku gjithmonë synojnë të provokojnë reagim kombëtar, siç është ndjenja e kërcënimit ose urretjes ndaj grupeve të tjera etnike, të cilat çojnë në simpati ndaj dhunës.<sup>97</sup>

Neonazizmi është i pranishëm midis maqedonasëve etnik ku disa grupe aktive janë të ndërlidhura. Aktivitete e tyre janë të errëta dhe të fshehta nga syri publik, kryesisht të pranishëm në Manastir dhe Shkup, por po ashtu kanë disa ndikime edhe mbi tifozërinë e futbollit,<sup>98</sup> si *Komitat*, tifozët e klubit futbollistik Vardar. Aktivitete e tyre përfshijnë praninë e simboleve në hapësira publike, dhe synojnë të shtyjnë përpara diskursin e Maqedonisë së pastër etnike dhe ekspozojnë urretje ekstreme ndaj shqiptarëve, grekëve dhe romëve.<sup>99</sup> Ka indikacione se neonazistët janë të pranishëm edhe në *Fronti Radikal Maqedonas Sarisa* e cila promovon idenë e rrënjëve etnike dhe vazhdimësinë historike të popullit maqedonas, ideologji kjo që kryqëzohet me ideologjinë e organizatave të tjera maqedonase të EKD-së.<sup>100</sup> Edhe pse neonazistët janë me ndikim marginal, racizmi dhe gjuha e urretjes janë shpërndarë shumë në internet.<sup>101</sup> Ekstremizimi i krahut të djathtë dhqiptar syonën një autonomi më të madhe për shqiptarët etnik ose Shqipërinë e Madha.<sup>102</sup> Retorika e fortë kundër Marrëveshjes së Ohrit dhe promovimi i aspiratave nacionaliste territoriale mund të gjenden edhe online edhe në hapësira publike për shembull me anë të grafitit. Në Tetovë, tifozët e klubit futbollistik Shkendija shprehin ndjenja kundër sllavëve, sidomos kundër maqedonasëve dhe serbëve.<sup>103</sup>

Mediat sociale përdorn shumë nga aktivistët për të fituar mbështetje dhe për të promovuar idetë e krahut të djathtë ekstremist.<sup>104</sup> Si në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, EKD-ja është bërë më i pranishëm dhe më me ndikim online nën ndikimin e pandemisë COVID-19 dhe të teorive konspirative.<sup>105</sup> EKD-ja maqedonase ka lidhje rajonale. Ndërkohë që disa kanë lidhje të ngushta me ekstremizmin e krahut të djathtë serb dhe rus, disa të tjerë janë më afër organizatave evropiane të krahut të djathtë ekstremist. Për shembull, grusht shteti i tentuar në 2017 përfshinte një serb i cili kishte marrë pjesë në luftën ukrainase. Nga ana tjetër, ekstremistët e krahut të djathtë shqiptar janë të afërt me homologët e tyre në Shqipëri dhe Kosovë.<sup>106</sup> Njohja e ndikimit që grupet rajonale politike dhe ekstremiste, të tillë si serbë dhe ashqiptarë,

<sup>91</sup> Zdravkovski, *North Macedonia*, 100-101.

<sup>92</sup> Zdravkovski & Morrison, *The Orthodox Churches of Macedonia and Montenegro: The Quest for Autocephaly*.

<sup>93</sup> Kambovski et al., *National Approaches to Extremism. North Macedonia*, 6.

<sup>94</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 12.

<sup>95</sup> Zdravkovski, *North Macedonia*, 101.

<sup>96</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 12-13.

<sup>97</sup> Milekic et al., *Far-Right Balkan Groups Flourish on the Net*.

<sup>98</sup> Zdravkovski, *North Macedonia*, 100-101.

<sup>99</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 12-13.

<sup>100</sup> Neofotistos, *Sport and nationalism in the Republic of North Macedonia*, 110-122.

<sup>101</sup> Zdravkovski, *North Macedonia*, 100-101.

<sup>102</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 11, 13-14.

<sup>103</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 13; Saveski & Sadiku, *The Radical Right in Macedonia*, 5-6.

<sup>104</sup> Zdravkovski, *North Macedonia*, 100.

<sup>105</sup> Huszka & Lessenska, *Viral vulnerability: How the pandemic is making democracy sick in the Western Balkans*.

<sup>106</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 11-13.

ushtrinë mbi ekstremizimin e krahut të djathtë është shumë e rëndësishme për parandalimin e radikalizimit dhe implementimin e politikave të P/KEDH-së.

Maqedonia e Veriut ka një kornizë ligjore që ndalon organizatat e EKD-së dhe aktivitetet e tyre, por siç duket asnjëherë nuk është shfrytëzuar. Nevojiten vendime nga qeveria për kufizimin ose ndalesën e organizatave potenciale të EKD-së. Siç e ceku edhe Oliver Spasovski, ministër i Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut, ekstremizimi është "një rrezik real".<sup>107</sup> Mbikëqyrja dhe kontorlli i aktivistëve të EKD-së është një nga çështjet e rëndësishme operative të sigurisë. Kështu që trajnimi i profesionistëve (përfshirë këtu personelin e sigurisë dhe të gjyqësorit) mund të konsiderohet si hap i rëndësishëm për P/KEDH. Aktorët lokale të P/KEDH-së dhe OJQ-të duhet të përfshihen në trajnim, në hulumtim, në dizajnimin dhe implementimin e politikave për parandalimin e EKD-së, të udhëheqin aktivitetet e P/KEDH-së duke u përqendruar mbi ekstremizimin e krahut të djathtë. Kjo duhet të përfshijë trajtimin e aktivitetëve online të EKD-së, çështjet që kanë të bëjnë me identitetin dhe ato politike, por po ashtu edhe situatën e përgjithshme ekonomike, e cila negativisht ndikon situatën politike në vend.<sup>108</sup>

#### f. Serbia

Gjatë vitit 1988/89, inteligjenca, elitat dhe politikanët e Serbisë bashkuan forcat për të inkurajuar një revolucion kombëtar që të krijojë një "Serbi të bashkuar" duke shfrytëzuar pakënaqësitë socio-ekonomike dhe kombëtare të serbëve në republikën e ish-Jugosllavisë. Në vitet pasuese Serbia bëri disa reforma të rëndësishme për anëtarësim në BE në fushën e procesit të anëtarësimit në BE,<sup>109</sup> por rënia e dhunshme e Jugosllavisë dhe pasojat pas rënies së saj ende e mendojnë Serbinë edhe sot. Kjo vështirësi që të pajtohen me të kaluarën bashkë me cenueshmëri të tjera, si joqëndrueshmëria e thellë ekonomike dhe mediat sociale jokritike, shfrytëzohen nga ekstremistët e krahut të djathtë për radikalizim.<sup>110</sup> Luftrat gjatë 1990-ve ndihmuan formësimin e EKD-së serbe duke vënë nacionalizimin ekstrem lartë në agjendën politike.<sup>111</sup> Narrativi kryesor i EKD-së serbe është se territoret serbe padrejtësisht janë veçuar nga vendi gjatë luftratve të 1990-ve dhe qëllimi kryesor i tyre është unifikimi i "tokave dhe popullit serb" (BiH, Kroaci, Kosovë, Mal i Zi dhe Maqedoni e Veriut).

Së paku 23 grupe të ekstremizimit të dhunshëm të krahut të djathtë (EDHKD) janë aktive në Serbia.<sup>112</sup> Ideologjitë e EDHKD-së janë të përgjithshme dhe të fshehta; përfshijnë lëvizjet ekstremiste të cilat kanë të bëjnë me identitetin, ultranacionalizimin, neonazizmin, krishterizmin ortodoks. Raportet potencojnë se dhuna dhe kërcënimet kundër migrantëve si dhe sulmet bazuar mbi urrejtje dhe identitetin etnik është pjesë e aktivitetit të tyre.<sup>113</sup> Organizatat e tilla si *1389, Partia Serbe Premtimbajtësit*, dhe *Lëvizja e Popullit Serb Nashi* në mënyrë deklarative refuzojnë fashizmin, kurse *Obraz (Nderi)*, *Fronti Kombëtar Serb*, *Gjak dhe Nder* dhe *Aksioni Serb* janë ose klerik-fashist ose neofashist. *Gjak dhe Nder Serbia* dhe *Fronti Nacional Serb* haptazi mbështetë superioritetin e të bardhëve dhe socializimin nationalist.<sup>114</sup> Liderët e organizatave të ekstremizimit të krahut të djathtë janë shumë me ndikim në rrjetet sociale. Për shembull, lideri i *Frontit Nacionalist Serb* – të cilit e referohemi si Führer – shpërndan postime kundërsemitike dhe raciste, të cilat shpesh rishpërndahen nga udhëheqës dhe organizata të tjera eskremiste të krahut të djathtë.<sup>115</sup>

Përveç kësaj, *Aksioni Serb* është bashkuar me *Frontin Kombëtar Serb* dhe ka një strukturë të ngjashme me hierarkinë ushtarake, e cila gjë i ndihmon takimet ose tubimet e kokërruarve.<sup>116</sup> *Partia Serbe e Premtimbajtësve*, *Dveri dhe Lëvizja e Lirisë së Popullit* janë kundër qeverisë dhe mbështesin narrativet e tyre rreth konservativizmit fetar. *Dveri* në mënyrë deklarative mbështesin narrativet kundër LGBTQ+, kurse *Lëvizja e Popullit Serb Nashi* mbështetë edukimin fetar ortodoks për të "mbrojtur" fëmijët nga LGBTQ+ dhe

<sup>107</sup> Kuloglija et al., *Balkan States Failing to Address Threat from Far-Right Extremism*.

<sup>108</sup> Kambovski et al., *National Approaches to Extremism. North Macedonia*, 10-17.

<sup>109</sup> Më shumë informacion mbi Serbinë, përfshirë edhe angazhimin e vendit kundër ekstremizmit të dhunshëm, mund të gjendet në raportin vijues për vendin në fjalë të Komisionit Evropian: *Raport mbi Serbinë 2021. 2021 Komunikatë mbi politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Versionin në gjuhë angleze e gjeni këtu: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/serbia-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/serbia-report-2021_en).*

<sup>110</sup> Klacar, *Serbia's Right-Wing Shift Risks Fuelling Extremism*.

<sup>111</sup> Halilovic Pastuovic et al., *Preventing and Addressing Violent Extremism: A Conceptual Framework*, 19.

<sup>112</sup> Kuloglija et al., *Balkan States Failing to Address Threat from Far-Right Extremism*.

<sup>113</sup> Personeli i Bashkimit Evropian, *Serbi Raporti mbi Serbinë 2021*, 37. Petrović & Ignjatijević. *Migranti odlaze, mržnja ostaje antimigrantska ekstremna desnica u Srbiji. Prevev and BCBP*.

<sup>114</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 6.

<sup>115</sup> Bego, *Serbia*, 107.

<sup>116</sup> Vio, *Young Patriots': Serbia's Role in the European Far-right*.

barazia gjinore. Ortodokësia është në thelbin e EDHKD-së serbe. Mbështeten mbi religjionin<sup>117</sup> dhe theksojnë elementet fetare të identitetit serb të cilët promovohen nga kisha ortodokse serbe. Narrativi zyrtar i ofruar nga kisha ortodokse serbe në disa raste ofron "kornizën kryesore" në të cilën këto organizata operojnë, përfshirë këtu ndjenjat pro Rusisë, kundër BE-së, kundër NATO-ës dhe kundër LGBTQ+, statusin e Kosovës, unifkimin e "tokave dhe popullit serb", dhe materializimi i kryerësve të krimeve të luftës.<sup>118</sup> Disa organizata të EKD-së shpërndajnë teori të konspiracionit lidhur me pandeminë, të tilla si *Jetojmë për Sërbinë* e cila shpërndan informacione të pasakta dhe përdor pandeminë si mundësi për tërheqje të vëmendjes nga publiku. Ata lidhen me *Lëvizja Vigane*, një organizatë e EDHKD-së e cila në publikë prezantohet si organizatë për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve. Aktivitete e tyre të dhunshme synojnë romët, migrantët dhe LGBTQ+. Udhëheqësi i *Lëvizjes Vigane Pavle Bihali* ka lidhshmëri me anëtarët e grupin neonazist të çikëlistëve *MC Srbi*.<sup>119</sup> Individë të ndryshëm të ekstremizmit të dhunshëm të krahut të djathtë janë përafërsisht të ndërthurura. Shembull, *Damnjan Knezevic* ndihmoi në themelimin e Premtimmbajtësve dhe hëpërhë një figurë e rëndësishme në *Patrolat e Popullit*, kryesisht një organizatë teoricienësh konspirative të EKD-së kundër qeverisë, kundër migrantëve, kundër LGBTQ+. *Patrolat e Popullit* pjesërisht përkohet me grupe formale/joformale të EKD-së, të tilla si grupi në Facebook *Mjaftë censurës*, dhe kryesisht shfrytëzon hapësirë online për rekturim.<sup>120</sup> Disa grupe serbe të EKD-së, si *Nderi Serb*, operojnë si organizata humanitare dhe kanë lidhje të hapura me Rusinë.

Edhe pse organizatat politike të EKD-së kanë një rol marginal në procesin e vendimmarrjes politike, sërish ata kanë një rol të rëndësishëm mbi mendimin publik dhe disa janë ngusht të lidhur ose në mënyrë indirekte me organizata politike që kanë fuqi politike. *Anëtarët e skenës së muzikës punk, metalike and elektrike* janë vetëm disa shembuj të variteteve subkulturale që tregojnë mbështetje për EKD-në në Serbi.<sup>121</sup> Për më tepër, tifozët njihen për mbështetjen e tyre të hapur ndaj EKD-së ku përfshihen tifozët e kulbit futbollistik të Beogradit – *Delije e Yllit të Kuq, Grobari të Partizanëve, dhe Forca e Bashkuar e Rad*. Përdorin imazhe historike të nacionalizmit serb dhe të krishterizmit ortodoks dhe janë të priurë ndaj dhunës, por po ashtu bëjnë edhe punë bamirësie. Një nga arsyt kryesore për mungesën e masave efektive për kundërveprim ndaj EKD-së<sup>122</sup> në mesin e tifozëve janë pozitativat dhe lidhjet e rëndësishme të politikanëve të shquar me klubet e futbollit, të cilët i kontrollojnë ata.<sup>123</sup> Ashtu siç e tha edhe Marija Srdić e Koalicionit Antifashist në Serbi, në një intervistë të saj për Balkan Investigative Reporting Network:

*“Pra ata organizata janë legjitime dhe shpesh mbështeten nga fonde të ndryshme dhe nga institucione të vendit dhe të huaja. Pra marrin të ashtuquajtur mbështetje legjitime për aktivitete e tyre”<sup>124</sup>*

Serbia është atraktive për disa nga ekstremistët e krahut të djathtë. Ata janë kapluar nga narrativi dhe imazhinata kolektive se Serbia ishte mbrojtës i Evropës nga invazionit islamik.<sup>125</sup> Pothuaj tërë organizatat EKD kanë lidhe ose tentojnë të lidhen me organozata të tjera të EKD-së në Evropë. Për shembull, *E djathta Serbe* iu bashkuar organizatës politike evropiane *Aleanca për Paqe dhe Liri*,<sup>126</sup> 1389 e cila ka një bashkëpunim të hapur me ekstremistët e krahut të djathtë nga Polonia, Rusia dhe Amerika e Jugut,<sup>127</sup> ndërsa *Alternativa për Gjermaninë*, nga e cila organizata e të rinjëve dhe suborganizata e ashtuquajtura *Flugel* zyrtarisht janë deklaruar "raste të dyshuara" si përpjekje potenciale ekstremiste nga agjencia e brendshme nacionale e inteligjences në Gjermani,<sup>128</sup> mbështeti udhëheqësin *Dveri - Bosko Obradović* - në zgjedhje.<sup>129</sup> Kalorësit Templar Ndërklombëtar (*Knights Templar International*) janë të njohur për

<sup>117</sup> Bego, *Serbia*, 107-108.

<sup>118</sup> Halilovic Pastuovic et al., *Preventing and Addressing Violent Extremism: A Conceptual Framework*, 19.

<sup>119</sup> Colborne, *Levijatan: Serbian Animal Rights Vigilantes Go to The Polls*.

<sup>120</sup> Vucic, *Hate, Lies and Vigilantes: Serbian 'Anti-Vaxxer' Brigade Plays With Fire*.

<sup>121</sup> Bego, *Serbia*, 109-111.

<sup>122</sup> European Commission Staff, *Serbia 2021 Report*, 48.

<sup>123</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 6-7.

<sup>124</sup> Kuloglija et al., *Balkan States Failing to Address Threat from Far-Right Extremism*.

<sup>125</sup> Mujanovic, *Why Serb Nationalism Still Inspires Europe's Far Right*.

<sup>126</sup> Bego, *Serbia*, 110.

<sup>127</sup> Milekic et al., *Far-Right Balkan Groups Flourish on the Net*.

<sup>128</sup> Bundesamt für Verfassungsschutz, *Fachinformation: Teilorganisationen der Partei "Alternative für Deutschland" (AfD)*.

<sup>129</sup> Radicevic, *"We Are Their Voice": German Far-Right Builds Balkan Alliances*.

radikalizmin online, me specializimin në përhapjen e memev, videove dhe materialeve të ndryshme nëpër Evropë dhe ka një prani të drejtpërdrejtë në Serbi. Ata përhapin një propagandë kundër muslimanëve, kundër migrantëve dhe propagandë raciste dhe përgjithsisht përhapin teori se imigrantët musliman do t'i zëvendësojnë të bardhët evropian.<sup>130</sup> Disa organizata të EKD-së kanë edhe filiale lokale në vendet fqinje, si *Gjak dhe Nderë* në BiH, të tjerat janë regjistruar si OJQ, si *Lëvizja Çetnike*, por e vetmja oranzatë politike e cila ka aktivitete politike në BiH, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut është *Partia Radikale Serbe*.<sup>131</sup> Serbia kishte një çështje sigurie që kishte të bëjë me ikjen e luftëtarëve të huaj prorus në luftën e Ukrainës.<sup>132</sup> Luftëtarët e huaj nga Ukraina perceptohen si mercenarë dhe zakonisht nuk ndiqen penalisht ose kanë trajtim të tolerant.<sup>133</sup> Një ditë para se Rusia të fillojë sulmin mbi Ukrainën në 2022, udhëheqësi serb çetnil i luftës Bratislav Zhivkoviç tha që "shumë vullnetar serbë janë të gatshëm të shkojnë në Donesk". Pasi filloi konflikti i armatosur, Zhivkoviç konfirmoi se luftëtarët e huaj serb arritën për të luftuar në anën e Rusisë.<sup>134</sup>

Aktivitetet serbe të EKD-së kanë ndikime reciproke mbi radikalizimin e minoriteteve hungareze, boshnjake dhe atë shqiptare. Disa organizata boshnjake dhe shqiptare marrin kahje separatiste dhe anojnë na EKD-ja. Shembull, organizatat dhe aktivistët politikë shqiptarë të EKD-së në Luginën e Preshevës, në jug të Serbisë, lavrdojnë degën lokale të ish-armatës së Kosovës.<sup>135</sup>

Disa politikëbërës serb nuk e ndien nevojën për P/KEDH në raport me EKD-në. Por, Strategjia Serbe Kundër Terrorizmit përfshinë trajtimin e EKD-së nëpërmjet motiveve dhe tendencave separatiste të cilat mund të rezultojnë në terrorizëm.<sup>136</sup> Shpesh kemi mungesë të vullnetit politik për klasifikim të P/KEDH si një kërcënim sigurie. Aktivistët dhe organizata e EKD-së janë të vetëdijshëm për sundimine e dobët të së drejtës dhe për reagimin (ndëshimin) e butë ndaj aktiviteteve të tyre.<sup>137</sup> Reformat juridike, strategjike dhe institucionale janë të nevojshme për të trajtuar P/KEDH-në, për shembull për kontrollimin e përmbajtjes në internet nga pjesa dërmuese e aktivistëve dhe kufizimi ose ndalesa e shumë organizatave të cilët paraqesin një rrezik për demokracinë dhe sigurinë, jo vetëm në Serbi por edhe në rajon.<sup>138</sup> OJQ-të duhet të fuqizohen edhe më shumë që të arrihet përhapja efektive e narrativeve të kundërta në mediat social.<sup>139</sup>

## Kontekstualizimi i radikalizimit të EKD-së dhe sfidat për P/DEDH-së në Ballkanin Perëndimor

EKD-ja dhe radikalizimi në Ballkanin Perëndimor nuk u shfaqën në vakum ose të izoluar. Shfaqet e para marginale të EKD-së në politikë dhe midis grupeve janë përshpejtuar avancimet teknologjike dhe nga kriza ekonomike, politike dhe shëndetësore (pandemia COVID-19). Sot, narrativet e EKD-së janë një dukuri shumë e ndërkombëtarëzuar, e zakonshme sa që nuk ndodh vetëm në platformat ekstreme.<sup>140</sup> Në Ballkanin Perëndimor, ndarjet ideologjike, cënueshmëritë dhe fyerjet edhe më tej shfrytëzohen nga fuqitë e huaja, si Rusia. Veprimet e tyre përshpejtojnë rënien e besimit në alencat ndërkombëtare, në institucione publike dhe në media, kurse narrativet shfrytëzojnë konflikte të pazgjidhura nga e kaluara për të vënë në lëvizje tensione rajonale ose ndëretnike. Krijimi i aleancave bazuar mbi vllazëri ortodokse dhe financimi i E/DHKD-së në Ballkanin Perëndimor mundësoi rekrutimin me sukses të luftëtarëve të huaj.<sup>141</sup> Sërish, me eskalimet e reja të konfliktit në Ukrainë dhe gjetiu krijohet edhe mundësia e ekzistimit të kërcënimit që aktivistët e E/DHKD-së të vazhdojnë të ikin për të marrë pjesë në luftë të huaj<sup>142</sup> dhe do të mbeten një kërcënim i

<sup>130</sup> Chua et al., *Responding to Violent Extremism in the Western Balkans*, 27.

<sup>131</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 10.

<sup>132</sup> Petrović, *The Problem of Islamist Extremism in Serbia: What are the drivers and how to Address Them*, 2.

<sup>133</sup> Kelly, *Overview of research on far-right extremism in the Western Balkans*, 9.

<sup>134</sup> Kuloglija & Husarić, *Serb Volunteers Answer Call to Fight in Ukraine*.

<sup>135</sup> Bego, *Serbia*, 107, 110.

<sup>136</sup> European Commission Staff, *Serbia 2021 Report*, 47

<sup>137</sup> Bego, *Serbia*, 111.

<sup>138</sup> Kuloglija et al., *Balkan States Failing to Address Threat from Far-Right Extremism*.

<sup>139</sup> Bego, *Serbia*, 111.

<sup>140</sup> Pauwels, *Contemporary manifestations of violent right-wing extremism in the EU: An overview of P/CVE practices*.

<sup>141</sup> Eisentraut & de Leon, *Propaganda and Disinformation in the Western Balkans: How the EU Can Counter Russia's Information War*, 3-4; Chua et al., *Responding to Violent Extremism in the Western Balkans*, 7, 9-10, 14; Rustemi, *Far-Right Trends in Southeastern Europe: The Influences of Russia, Croatia, Serbia and Albania*.

<sup>142</sup> Obrenović, *Novi zov rata u Ukrajini za dobrovoljce iz BiH i Srbije*.



rëndësishëm për sigurinë në Ballkanin Perëndimor.<sup>143</sup> Andaj, radikalizimi i EKD-së në Ballkanin Perëndimor mund të kuptohet nëpërmjet dinamikës dhe zhvendosjeve rajonale dhe më të gjera gjeopolitike.

Në Ballkanin Perëndimor, radikalizimi i EKD-së zakonisht është nga lartë-poshtë dhe reciprok. Është rezultat i një vargu kompleks i cili lidh politikat e përgjithshme, insitucionet fetare dhe lëvizjet të cilat kalërojnë në valën e EKD-së e cila ka prirje të bëhet e dhunshme,<sup>144</sup> motivuar nga meritë, traumat dhe frikat e luftrave.<sup>145</sup> Duke pasur parasysh shfaqjen e sulmeve të dhunshme në Perëndim të cilat u atribuohen esktrmistëve të krahut të djathtë - disa të frymëzuar nga nacionalizmi serb - dinamika të ngjashme paraqesin rrezik për Ballkanin Perëndimor, andaj nuk duhet të injorohen.<sup>146</sup>

Besimi i ulët në media, madje edhe niveli më i ulët sa i përket shkathtësive të mediave në Evropë dhe mungesa e gazetarisë kritike dhe të pavarur e bëjnë Ballkanin Perëndimor të cenueshëm ndaj lajmeve të rrejshme. Edhe pse disa hulumtime tregojnë se ndërveprimi me prezencë fizike është ende mekanizëm primar i rekturimit të EKD-së,<sup>147</sup> prapsepër gjithëprania online e narrativeve të EKD-së e kanë lehtësuar rekrutimin. Por, normalizimi i EKD-së në hapësira fizike me grafiti, monumente dhe parada ku në mënyrë simbolike shfaqin etnonacionalizim (fetar) paraqet shqetësime për BiH, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Si një ndër shtete më të cenueshme ndaj EDHKD-së, vërehet një harmonizim shqetësues i ekstremistëve të krahut të djathtë serb me politikën e përgjithshme, me mediat dhe insitucionet fetare në mbrojtje të qëllimeve irridentiste nëpërmjet politikave të buta (adaptoese).<sup>148</sup> Pothuaj tërë organizatat serbe të krahut të djathtë ekstrem janë të lidhura në rajon dhe veprojnë si një bartës të narrativeve të EDHKD-së në tërë Ballkanin. Disa nga aktivitetet e tyre transmetohen dhe veprimet e tyre online paraqesin një sferë për sigurinë e BiH, të Kosovës\* dhe të Malit të Zi. Edhe BiH është e prirë ndaj EDHKD-së duke pasur parasysh sfidat politike dhe socio-ekonomike me të cilat haset. Në kontekstin e BiH, të Kosovës\*, të Malit të Zi, të Maqedonisë së Veriut dhe të Serbisë, radikalizimi reciprok luan rolin e lokomotivës për EKD-në dhe ndez edhe më shumë marrëdhëniet tashmë të birshta. Diskuret e përdishtme politike japin një atmosferë të favorshme për radikalizim, ku krijohet një ndjenjë e këcënimit, e cila mund të qarkullojë midis palëve duke krijuar një rrezh vicioz të EKD-së ku si pasojë mund të kemi edhe EDHKD-së.

Siç u pa nga vetë punimi, asnjë vend nga Ballkani Perëndimor nuk ka aktivitete të insitucionalizuara të orientuara ka prevenimi dhe/ose kundërveprimi ndaj EDHKD-së. Aktorët e jashtëm luajnë një rol kyç në zhvillimin e masave të EDHKD-së në Ballkanin Perëndimor dhe pjesa dërmuese e tentativave të tyre synojnë të luftojnë eksremizimin islamik. Në disa vende si në BiH, Mal të Zi dhe Serbi ka nevojë për zgjerimin e analizës së radikalizimit i cili përfshinë EDHKD-në dhe nacionalizimin etnik. Prapsepër, kur bëhet fjalë për BiH dhe Sebinë, disa qeveri të Perëndimit kanë filluar investimet në projekte që synojnë luftimin e EDHKD-së të frymëzuar nga nacionalizimi etnik, por vëmendja ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor mbetet mbi nacionalizmin islamik.<sup>149</sup>

---

*“Dështimi në njohjen e kërcënimeve në prag që burojnë nga ndryshimi i rrethanave ekstremiste, kombinuar bashkë me përqendrimin e ngushtë mbi rreziqet afatëgjatë, mund të mallkoj rajonin me një rutinë të kot të zbatimit të zgjidhjeve të vjetra dhe parciale për problemet aktuale.”<sup>150</sup>*

---

Përveç kësaj, kemi edhe mungesë të një qasje kohezive ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor lidhur me E/DHKD-së dhe mungesë të komunikimit lidhur me programeve rrjedhëse që zhvillohen midis OJQ lokale dhe vendeve përkatëse.<sup>151</sup> Nevojitet trajtimi i qasjeve sipëspecifike sipas vendit dhe sipas rajonit për të prandaluar dhe/ose kundërvepruar ndaj E/DHKD-së në Ballkanin Perëndimor pasi shumica e grupeve të

<sup>143</sup> Rovčanin, *Šta trebata znati o posljednjem izvještaju o stanju sigurnosti u BiH*.

<sup>144</sup> Bego, *Spotlight on the Western Balkans: far-right trends in the region*, 46-51.

<sup>145</sup> Chua et al., *Responding to Violent Extremism in the Western Balkans*, 15; Buljubašić & Holá, *Historical Trauma and Radicalisation: How Can Intergenerational Transmission of Collective Traumas Contribute to (Group) Radicalisation?*, 13-16.

<sup>146</sup> Kuloglija et al., *Balkan States Failing to Address Threat from Far-Right Extremism*.

<sup>147</sup> Chua et al., *Responding to Violent Extremism in the Western Balkans*, 18, 28.

<sup>148</sup> Bego, *Spotlight on the Western Balkans: far-right trends in the region*, 46-51.

<sup>149</sup> Fetiu et al., *Preventing Violent Extremism in the Balkans and the Mena: Strengthening Resilience in Enabling Environment*, 17.

<sup>150</sup> GCERF & Atlantic Initiative, *Rehabilitation and Reintegration of Returning Foreign Terrorist Fighters (RFTFs) and Their Families in the Western Balkans Regional Needs Assessment*, 2-3.

<sup>151</sup> Fetiu et al., *Preventing Violent Extremism in the Balkans and the Mena: Strengthening Resilience in Enabling Environment*, 21.

EKD-së operojnë në mënyrë rajone dhe narrativet e tyre shtrihen përtje vendi të origjinës. Aktivitetet për P/KEDH-së duhet të adoptojnë qasje lartë-poshtë dhe poshtë-lartë dhe të mbështeten mbi inkluzivitet dhe ndjenjën e përkatjes. Ky punim ofron rekomandime të përgjithshme rajonale dhe sipacificike sipas vendit lidhur me P/KDHE.

## Rekomandime

